



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.883/ 6 prot

Datë 23.04.2025

V E N D I M
Nr.552/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KAZAZI- MEAT” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38577-02-19-2025, me objekt: “Loti I Blerje mish dhe nënprodukte të tij”, me fond limit 11,099,205.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Ankimues: Operatori ekonomik “KAZAZI- MEAT” SHPK me NIPT K73609801E dhe adresë: Kanaparaj, Ura e Leshniqes, zona kadastrale nr.2071, pasuria nr.744, Golem, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “GEA” SHPK me NIPT K33931040W dhe adresë: Korçë, Maliq, Blloku nr.4, zona kadastrale 2573, nr.pasurie 4/442

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.02.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38577-02-19-2025, me objekt: “Loti I Blerje mish dhe nënprodukte të tij”, me fond limit 11,099,205.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 07.03.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 21.03.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

- GEA SHPK	8,690,100	lekë	kualifikuar
- Kazazi-Meat SHPK	9,142,180	lekë	kualifikuar
-Agent Daci SHPK	10,094, 420	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 28.03.2025 është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.04.2025 operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2025/5208 dhe me nr.883 prot., datë 03.04.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38577-02-19-2025, me objekt: “Loti I Blerje mish dhe nënprodukte të tij”, me fond limit 11,099,205.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GEA” SHPK.

Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret për të cilat operatori ekonomik “KAZAZI-MEAT” SHPK me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5208 dhe me nr.883 prot., datë 03.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “GEA” SHPK. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “GEA” SHPK të kriterëve si më poshtë:

2.3.2 *Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licensë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:*

Për OE/BOE :

Licensa të jetë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licensa duhet të jetë në emër të OE të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga AK.

2.3.4 *Operatori e Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira ambient të përshtatshëm për therjen, tregtimin dhe magazinimin e produkteve të mishit të paisur me leje higjeno-sanitare të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, për të cilin duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e marrjes me qira të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.*

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë per disponimin dhe adresen e saktë te ambientit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të ambientit.

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

Për OE/BOE :

Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.883/1 prot., datë 04.04.2025.

II.7. Përmes shkresës me nr. 1440/15 prot., datë 18.04.2025 protokolluar me tonën me nr. 883/2 prot., datë 22.04.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP aktin e trajtimit të ankesës ku përmes vendimit nr. 1440/11 prot., datë 16.04.2025 KSHA ka vendosur pranimin e saj konkretisht duke argumentuar: “[...]Per sa pretendohet nga pala ankimuese "KAZAZI-MEAT" sh.p.k, Numri i Nipt-it K73609801E

Në lidhje me Operatorin" G E A" shpk me Numri i Nipt-it K33931040W Referuar Urdhrit nr. 366 prot dat 08.09.2021 pika 2 Ministrisë Bujgesis dh Zhvillimit Rural kerkuam informacion AKVMB për të na mundësuar listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitet (therje kafshëve) nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar të AKVMB.

Referuar listes së ardhur nga ky institucion më datn 14.04.2025 operatorit" G E A" shpk me Numri I Nipt-it K33931040W nuk figuron në listë.

Duke genë se operatori " G E A" shpk me Numri i Nipt-it K33931040W nuk është në listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin (therje) të ardhura nga AKVMB.

Sa mësipër, pretendimi i ofertuesit qëndron.

Për sa u trajtua më lart, personi i Shqyrtimit të Ankesës,

VENDOSI:

1. Te pranoje ankesës të ofertuesit "KAZAZI- MEAT" sh.p.k, Numri i Nipt-it K73609801E për kontratën me numër të referencës: REF-38577-02-19-2025, me objekt: "Blerje mish dhe nenprodukte të tij".

II.8. Vendimin e KSHA për trajtimin e ankesës autoriteti kontraktor e ka ngarkuar edhe në sistemin e ankesave elektronike me datë 23.04.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 883/3 prot., datë 23.04.2025.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 *te lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kazazi Meat” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GEA” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Përmes shkresës me nr. 1440/15 prot., datë 18.04.2025 protokolluar me tonën me nr. 883/2 prot., datë 22.04.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP aktin e trajtimit të ankesës ku përmes vendimit nr. 1440/11 prot., datë 16.04.2025 KSHA ka vendosur pranimin e saj konkretisht duke argumentuar: *“[...]Per sa pretendohet nga pala ankimuese "KAZAZI-MEAT" sh.p.k, Numri i Nipt-it K73609801E*

Në lidhje me Operatorin" G E A" shpk me Numri i Nipt-it K33931040W Referuar Urdhirit nr. 366 prot dat 08.09.2021 pika 2 Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kerkuam informacion AKVMB për të na mundësuar listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitet (therje kafshëve) nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar të AKVMB.

Referuar listes së ardhur nga ky institucion më datn 14.04.2025 operatort" G E A" shpk me Numri I Nipt-it K33931040W nuk figuron në listë.

Duke genë se operatori " G E A" shpk me Numri i Nipt-it K33931040W nuk është në listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin (therje) të ardhura nga AKVMB.

Sa mësipër, pretendimi i ofertuesit qëndron.

Për sa u trajtua më lart, personi i Shqyrtimit të Ankesës,

VENDOSI:

1. Te pranoje ankesës të ofertuesit "KAZAZI- MEAT" sh.p.k, Numri i Nipt-it K73609801E për kontratën me numër të referencës: REF-38577-02-19-2025, me objekt: "Blerje mish dhe nenprodukte të tij".

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kazazi Meat” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38577-02-19-2025, me objekt: “Loti I Blerje mish dhe nënprodukte të tij”, me fond limit 11,099,205.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 1440/11 prot., datë 16.04.2025 të dërguar në KPP përmes shkresës me nr. 1440/15 prot., datë 18.04.2025 protokolluar me tonën me nr. 883/2 prot., datë 22.04.2025
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kazazi Meat” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

